



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 157 Prot

Tiranë, më 29.12.2010

VENDIM Nr. 20 dt. 22.12.2010

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 22.12.2010, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

VENDOSI:

I. Lidhur me diskutimin e projekteve:

1. **Miratohet:** "Projekt për restaurimin, rigjallërimin dhe rivlerësimin e kalasë së periudhës mesjetare në Lezhë", **me kondicionet:**
  - Zbatimi i projektit të fillojë me konsolidimin dhe restaurimin e murit që paraqet rrezikshmëri rënie.
  - Të hiqet odeoni.
  - Të hiqet fusha e tenisit. Ambienti i saj të vishet me bar dhe të parashikohet vendosja e disa stolave.
  - Të parashikohet një rrethim estetik i objektit dhe të paraqiten detjet e tij.
  - Projekti i arredimit të brendshëm të hartohet nga një arkitekt dhe të merret në shqyrtim nga KSH dhe KKR.
2. **Lidhur me:** Studim – Projektim të bulevardit kryesor "Republika", shëtitorja "Osumi" rrugët lidhëse me bulevardin, Berat.  
**Miratohet projekti i zbatimit të shëtitores, me kondicionet:**
  - Të rakordohet me IMK, për llojin e ndriçuesve që do të vendosen në shëtitore.
  - Kalldrëmi për shtrimin e shëtitores të jetë neutral.
  - Të rikonceptohen projektet e mobilimit të shëtitores dhe vendeve të parkimit dhe të risillen për tu shqyrtuar në KSH dhe KKR.
3. **Miratohet:** Ndërhyrje kons. rest. Fjetja e Pashkëve, Kisha e Shën Marisë në Spile, Tranashisht, Gjirokastër.
4. **Miratohet:** Ndërhyrje kons. rest. Ikona "Një Shënjtör", Kisha e Shpërfytyrimit, fshati Mingul, Gjirokastër (nr. i kart. 651)
5. **Miratohet:** Ndërhyrje kons. rest. Ikona "Shën Maria, kisha e Shpërfytyrimit, Mingul, Gjirokastër.
6. **Miratohet:** Ndërhyrje kons. rest. Ikona "Një Shënjtör", Kisha e Shpërfytyrimit, fshati Mingul, Gjirokastër (nr. i kart. 645)
7. **Miratohet:** Ndërhyrje kons. rest. Ikona "Ngritja në Qiell", Kisha e Shën Apostujve, Hoshtevë, Gjirokastër

8. **Miratohet:** Ndërhyrje kons. rest. Ikona "Kryqëzimi i Krishtit", Kisha e Shën Kollit, Krutje e Sipërme, Lushnje.
9. **Lidhur me:** Projekt konsolidimi, restaurimi Kulla Rrethore në Kanalin e Çukës, Butrint. **Miratohet projekti i konsolidimit të kullës dhe rrethimi i saj me parapet.**
10. **Miratohet:** Projekt rikonstruksioni, restaurimi i banesës dy katëshe me pronar Z. Klearko Likoka, Himarë-fshat.
11. **Nuk u diskutua:** Projekt restaurimi i pikturës murale në kishën e Shën Thanasit, shek. XVIII, Karavasta, Lushnjë.

## II. Lidhur me:

### Diskutim mbi statusin e monumentit të kulturës "Ish Shtëpia e Pionierit", Shkodër

Bazuar në nenin nr. 24, pika 3 dhe nenin 28, pika 4, në ligjin 9048, i ndryshuar, "Për trashëgiminë kulturore", KKR ti propozojë Ministrit, heqjen e statusit monument kulture, për objektin "Ish shtëpia e pionierit", Shkodër.

## III. Lidhur me:

### Diskutim i kërkesës për paisje me licensë restaurimi i shoqërisë "Salillari".

Miratohet kërkesa për pajisje me licensë restaurimi të kategorisë C, për shoqërinë "Salillari", me drejtues teknik Valter Shtylla.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

FERDINAND XHAFERAJ

SEKRETAR I KKR

AKADEMIK. APOLLON BAÇE